



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701519/6

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për parandalimin e vetvarjeve të të burgosurve në IEVP Lezhë dhe në IEVP të tjera*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Arben ÇUKO

TIRANË

Drejtorit të IEVP Lezhë
Z. Shaban HYSA

LEZHË

*I nderuar Z. Çuko,
I nderuar Z. Hysa,*

Institucioni i Avokatit të Popullit kreu një hetim me iniciativë për vdekjen e të burgosurit F. K., i cili sipas mediave ishte vetvarur në IEVP Lezhë në paraditen e datës 21.11.2017.

Për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohej janë kryer veprimet hetimore si vijon: marrja e shpjegimeve nga të burgosurit shokë dhome me F. K. dhe nga të burgosurit që e kanë gjetur atë të vetvarur; kqyrja e vendit ku i dënuari F. K. ka varur veten; kqyrja e regjistrit të aktivitetit 24-orësh, të hyrje-daljeve të të burgosurve, të personelit dhe të librit të lënies së detyrave në seksionin ku ka ndodhur ngjarja; kqyrja e regjistrit të terapisë mjekësore; kqyrja e dosjes psiko-sociale të të burgosurit F. K.; marrja e informacionit për organikën e stafit shëndetësor dhe social.

Sipas materialit të mbledhur rezulton se, i vetmi episod që mund të shërbente si tregues për personelin e IEVP Lezhë se i dënuari F. K. shfaqte shenja të një rreziku për vetvrasje ka qenë ai i regjistruar në datën 21.11.2017, ora 04:00, kur F. është gjetur nga bashkëvuajtësit i shtrirë në dhomë duke thënë se dëgjonte zëra.

Shokët e dhomës së F. kanë vënë në dijeni punonjësit e policisë së sektorit dhe shefin e policisë se, gjëndja e tij psikologjike ishte e rënduar. Një nga shokët e dhomës të të ndjerit i ka kërkuar punonjësve të policisë që F. të vizitohej nga psikologu dhe të përshpejtohej takimi e tij me familjarët që mbanin radhën jashtë burgut. Familjarët e F. kishin ardhur për të marrë takim me të pasi janë njoftuar një ditë më parë për gjëndjen psikologjike, në cilën ai ndodhej. Personeli i burgut nuk e ka vlerësuar si një rast të mundshëm vetvrasje pasi, ndihmësmjeku që e ka vizituar F. ditën e vetvarjes në të gdhirë ka konstatuar se, tensioni i tij ka qenë në parametra normal; vlerësimet periodike të stafit social nuk kishin identifikuar faktorë risku; i ndjeri, paraditen e vetvrasjes, kishte dalë rregullisht në ajrosje dhe kishte telefonuar familjarët.

Ky rast tregon se, një shqetësim psikologjik në dukje i parëndësishëm si pagjumësi, luhatje humori, apati etj., mund ti shërbejë si informacion personelit të burgut për të kuptuar se kemi të bëjmë me një rrezik të shtuar vetvrasje. Punonjësit e policisë, që përbëjnë frontin e parë të parandalimit të vetvrasjeve, duhet të informojnë për këto episode jo vetëm personelin shëndetësor por edhe atë social, të cilët sa më parë duhet të marrin takim me të dënuarin që paraqet rrezik potencial. Gjithashtu duhet të lihen detyra për personelin e sektorit që të vigjilojnë të dënuarin gjatë veprimeve të tij në ambientet që nuk monitorohen nga kamerat, të paktën për disa ditë pas regjistrimit të episodit.

Vetvarja e të dënuarit F. K., ashtu si edhe disa vetvarje të tjera në burgje, ka ndodhur në ambientin e tualetit të përbashkët. Të dënuarit shfrytëzojnë shpesh mundësitë që krijon ambienti i amortizuar ose jo i ndërtuar sipas standarteve për të kryer aktin e vetvarjes. Nga hetimi i vetvarjes së një të dënuari në IEVP Rrogozhinë rezultoi se, ai e kishte fiksuar telin për tu varur në hapësirën e krijuar ndërmjet kornizës së derës dhe murit në tualetin e përbashkët. Kjo hapësirë ishte krijuar nga amortizimi i murit dhe i derës së drurit. Ndërsa F. K. e ka realizuar vetvarjen duke shfrytëzuar derën e dërrasës të vendosur sipër murit të një prej bokseve të tualetit. Kjo derë është vendosur për të pritur ujën që rrjedh nga tavani si pasojë e amortizimit të ambientit të tualetit. Rregullimi i tualetit dhe dushit në mënyrë që të burgosurit të privohen nga mundësia për të fiksuar tela, çerçafë apo litarë do të parandalonte vetvarjet në këto ambiente.

Referuar informacionit të marrë në IEVP Lezhë, organika e sektorit shëndetësor dhe social nuk ishte e plotësuar. Mungonte një mjek, një ndihmësmjek dhe tre edukatorë. Edhe mjeku që shërbente ishte i punësuar me kohë të pjesshme. Ai punonte vetëm 2 ditë në javë. Mungesat në organkën e personelit shëndetësor dhe social ndikojnë në cilësinë e shërbimit që ofrojnë këto dy sektorë. Rrjedhimisht zvogëlohet edhe mundësia për të parandaluar rastet e vetvrasjeve.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

JU REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti dhe përgjithësimin i tij në të gjitha IEVP-të në mënyrë që personeli policor, shëndetësor dhe ai social të vlerësojë më saktë rrezikun për vetvrasje që paraqet një i burgosur;
- Rregullimin e tualeteve dhe dusheve të amortizuara në mënyrë që të burgosurit të privohen nga mundësia për të fiksuar tela, çerçafë apo litarë;
- Plotësimin e organikës së sektorit shëndetësor dhe social në IEVP Lezhë me punonjës që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Urdhërin Nr.6783, datë 13.11.2017 të Ministrit të Drejtësisë.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI